



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shënim: Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë UKD sh.a dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të nenit 26/2 të VKM-së të sipërcituar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara

në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Në rast se operatorët ekonomikë të kualifikuar i pari janë bashkim operatorësh ekonomikë secili prej operatorëve ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm, marrëveshjen e bashkëpunimit sipas së cilës janë krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe deklaratën për caktimin e përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë.

2 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 40% të fondit limit.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.

2.3 Kapacitetin profesional dhe teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, kontratën midis paleve ku të shënohet preventivi dhe vlera dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e Cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalente, (e vlefshme), lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim, si dhe të jete në përputhje me objektin e prokurimit. Certifikata duhet të jete e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për tregtimin e mallrave objekt prokurimi në territorin e Shqipërisë. Në rastin e autorizimit të distributorit duhet paraqitur dhe marrëveshja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Secili nga dokumentat e paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website në rast verifikimi nga ana e autoritetit kontraktor.

2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fotografi/katalogë/ broshurë ose fragmente(faqe) të katalogut/eve të lëshuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pajisjet që oferton, me specifikimet përkatëse të markuara, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat në DT, si dhe të plotësohen të dhënat sipas tabelës së mëposhtme.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

2.4.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të vërtetojë përputhshmerinë e produkteve të ofertuara me standardet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor në specifikimet teknike. Në përmbushje të kësaj pike duhet të paraqiten certifikatat e lëshuara nga prodhuesi ose nga institucione të pavaruara të akredituara të cilat vërtetojnë përputhshmerinë e modeleve të produkteve me standardet/normat/referencat e kërkuara në shtojcën e specifikimeve teknike.

2.4.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një tablele, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga ofertuesi për të gjithë zerat objekt prokurimi. Në plotësim të kësaj kerkese Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si mëposhtë:

Nr	Emertimi i produkteve	Emertimi kompanise prodhuese, adresa , ëeb-siti	Emertimi i katalogut	Referenca ne katalogje/	Shënimet
				KOD I produktit ose nr. Faqes ne katalog	

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK. Emri, Adresa dhe website i kompanise prodhuese, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim, Emertimi i Katalogut të prodhuesit., Referenca në katalogje, kodi i produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut ne katalogun perkates ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

2.4.6 Ofertuesi deri ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave duhet te paraqesi mostrat prane Autoritetit Kontraktor. Produktet te cilat kerkohen te paraqiten mostrat jane te renditura si meposhte sipas numrit rendor ne preventiv:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Driver LED 60W/1400mA	cope	1
3	Drozela 150w me peshtjell cu ose Drozela 250w me peshtjell cu	cope	1
5	Llampa 150w E40 sodium ose Llampa 250w E40 sodiumi	cope	1
8	Llampa led E27 50w 4000k ose Llampa led E27 65w 4000k	cope	1
10	Llampa led filament E14 5W	cope	1
11	Inglitrona 70 - 400W	cope	1
12	Automat 4P 160A	cope	1
13	Automat 4P 80A ose Automat 4P 63A	cope	1
15	Automat 1P 6A/10A/16A/63A	cope	1
19	Leshues magneto termik 4P 100A ose 63A	cope	1
21	Prozhektor LED 100W, 4000K, 9000lm, 220V-240V AC ose 50W ose 30W	cope	1
24	Tub fleksibel PVC D50/25/16	MI	1

27	Kabell 3x1.5mm cu	MI	1
28	Kabell 2x1.5mm cu	MI	1
29	Kabell 2x2.5mm cu	MI	1
30	Kabell 4x2.5mm cu	MI	1
31	Kabell 4x4mm cu	MI	1
32	Kabell 4x6mm cu	MI	1
33	Kabell 4x16mm cu	MI	1
34	Kabell ABC 2x16mm al	MI	1
35	Kabell tokesor 4x16mm al	MI	1
36	Konektor 1.5-35/ 6-150mm abc	cope	1
37	Tirantues abonenti abc	cope	1
38	Fotoelemente muzgu 10a-16a ip65	cope	1
40	Panel metalik Gj400xL500XTh200 IP65	cope	1
42	Nastro izolant	cope	1
43	Nastro uji	cope	1
44	Tub izolues me ngrohje set 16-120mm	cope	1
45	Drajver 60W 1400mA	cope	1
46	Drajver 75W/ 1400mA	cope	1
47	Drajver 150W/ 2800mA	cope	1
48	Ndricues rrugor Led 100W 4000K IP65	cope	1
49	Ndricues rrugor Led 50W 4000K,IP65	cope	1

Shenim shpjegues: Une j.h dhe L. G. do te firmosin tek pika e kriteri ekonomik 1,2,2.1,2.2,dhe 2.3 vetem tek keto kritere qe ka formati standart,persa I perket pikes se kritreve te tjera tkenike kualifikuese do ti firmosi anetari I njesise Z/Z. S me detyre si Jurist .

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT

Zambak Selmani **Jurist**

Lisandro Ganaj **Elektricitist**

Jetmira Hanaj **Ekonomist**